



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020.
2. Pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018-2020 është edhe Programi i Borxhit Shtetëror 2018-2020.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që dokumentet sipas pikës 1. dhe 2. të këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2017.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 45 të Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 06/17, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 02/137

1. Ndryshohet dhe plotësohet nënpika 1.7. e Vendimit nr. 06/17 të datës 07.03.2015 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 02/137 të datës 14.03.2017, kështu që për vitin 2017 z. Fatos Shllaku, nga Këshilli i Investitorëve Evropian, emërohet anëtar i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar.
2. Ky Vendim paraqet pjesë përbërëse të Vendimit nr. 06/17 të datës 07.03.2015 dhe Vendimit nr. 02/137 të datës 14.03.2017.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve në shumë prej 26,401.63 euro, për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, nën kategoria ekonomike e Rezervës, me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi Dogana, me kod 13300, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, nën kategoria shpenzimet e anëtarësimin, me kod 13480.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 11. të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre, të nenit 4 paragrafi 1. të Rregullores (QRK) nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.10/2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Minire Begaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - kryetare;
 - 1.2. Jeta Krasniqi, përfaqësuese nga shoqëria civile - nënkryetare;
 - 1.3. Mentor Borovci, Zyra e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.4. Feride Podvorica, Ministria e Drejtësisë - anëtare;
 - 1.5. Nazmije Kajtazi, Ministria e Shëndetësisë - anëtare;
 - 1.6. Fetnete Ramosaj, Instituti për Krime Luftë - anëtare;
 - 1.7. Xhevahire Balaj, psikologe klinike - anëtare;
 - 1.8. Shpend Haxhibeqiri, psikiatër - anëtar;
 - 1.9. Leonora Selmani, juriste - anëtare.
2. Mandati i Komisionit nga pika 1. e këtij vendimi është 5 (pesë) vjeçar.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të gjitha institucionet tjera, që janë të përfshira sipas legjislacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës ("MASHT") dhe Stitching SPARK-ut të Holandës ("SPARK") mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

**Për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërmintor për zhvillimin e Projektit
Autostrada "Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë"**

1. Emërohet Komiteti Drejtues Ndërmintor për zhvillimin e Projektit Autostrada "Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë", në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Infrastrukturës - kryesues;
 - 1.2. Ministri i Financave - anëtar;
 - 1.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë - anëtar;
 - 1.4. Ministri i Zhvillimit Ekonomik - anëtar;
 - 1.5. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - anëtar.
2. Për marrjen e vendimeve nga Komiteti Drejtues Ndërmintor kërkohet vota afirmative e shumicës së anëtarëve të Komitetit, duke përfshirë votën afirmative të Ministrit të Infrastrukturës dhe Ministrit të Financave.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 432.000,00 (katërqindetridhjetëedy mijë) euro, për parandalimin dhe luftimin e sëmundjes gungore të lëkurës së gjedhit.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike shpenzimet Kapitale, projekti "Shpenzimet e paparashikuara 2017-2019" me kod 13255, nën kategoria ekonomike me kod 31110 dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit, në nën programin Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me kod 40800, në kategorinë e shpenzimeve kapitale për projektin "Mbrojtja e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve me anë të vaksinimeve kundër sëmundjeve infektive të kafshëve" me kod 10014, në nën kategorinë ekonomike 31920 - blerja e vaksinave.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 350.000,00 (treqindpesëdhjetë mijë) euro, për dezinfektimin e hapësirave të ekspozuara nga ethet hemorragjike, krime kongo.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kod 203, në nën programin Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve me kod 40100, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, nën kategoria ekonomike, shërbime kontraktuese tjera me kod 13460.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/143
Datë: 28.04.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro, për Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, për realizimin e projektit të ndërtimit dhe vendosjes së Shtatores së re të Dëshmorit Edmond Hoxha në Junik.
2. Mjetet financiare nga pika e 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe barten në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kodin 208, nën programi Administrata Qendrore me kod 11308, kategoria ekonomike subvencionet dhe transferet, nën kategoria ekonomike subvencionet për entitetet jopublike me kod 21200.
3. Mjetet financiare nga pika 1. dhe 2. e këtij vendimi obligojnë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që t'i bartin mjetet në Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së në xhirrolloarinë nr. 170 100 1010 734491 në NLB Prishtina.
4. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë